



PERMBLEDHJE JO TEKNIKE E VNM

MIELL TIRANA

FABRIKE PER PRODHIMIN E PRODUKTIT USHQIMOR MIELL, NGA TRAJTIMI DHE PERPUNIMI I LENDES SE PARE BIMORE GRURE/DRITHRA, ME ADRESE NE : BLV TEODOR KEKO, RRUGA AGIM QARRI N.1, NJESIA BASHKIAKE N.6, TIRANE

Pasqyra:

1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT	3
1.1. Te pergjithshme	3
1.1.1. Hyrje	3
1.1.2. Te dhena te pergjithshme.....	3
1.1.3. Menyrat e punes (programimi i sherbimit; programimi i prodhimit).....	4
1.1.4. Te dhenat dhe vellimi i projektit	7
1.2. Proceset kryesore te perpunimit te grurit	8
1.3. Qellimi dhe karakteristikat fizike te objektit	8
1.4. Kerkesat mbi perdorimin e tokes	9
1.5. Pjesa e pergjithshme dhe transporti	10
1.5.1. Vendndodhja e sheshit te ndertimit	10
1.5.2. Plani i pergjithshem dhe kompozimi i objektit	10
1.5.3. Transporti i brendshem	10
1.6. Sistemet inxhinierike	10
1.6.1. Furnizimi me uje dhe kanalizimet	10
1.6.2. Furnizimi me energji elektrike dhe nderlidhja.....	10
1.6.3. Ndricimi.....	10
1.6.3.1. Ndricimi i brendshem	10
1.6.3.2. Ndricimi i jashtem.....	10
1.6.3.3. Nderlidhja.....	11
1.7. Mbrojtja e objektit.....	11
1.7.1. Mbrojtja nga renia nen tension	11
1.7.2. Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike	11
1.7.3. Mbrojtja nga zjarri	11
1.7.4. Organizimi menaxherial i punes	11



1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

1.1. Te pergjithshme

1.1.1. Hyrje

Veprimtaria: Fabrike per prodhimin e produktit ushqimor miell, nga trajtimi dhe perpunimi i lendes se pare bimore grure/drither.

Vendodhja: Blv. Teodor Keko, Rruga Agim Qarri n.1, Njesia Bashkiake nr.6, Tirane.

Kapaciteti perpunues ditor: 240 ton/dite

Fuqia e instaluar: 100 kW

Siperfaqe sheshit te ndertimit: 13 210.0 m²

Siperfaqe ndertimi: 3179.0 m²

"Miell Tirana" sh.a. eshte themeluar ne vitin 1995, si rezultat i privatizimit te ish N.SH.G.P. te Drithrave. Me privatizimin e kesaj shoqerie ne vitin 1995, drejtimi i "Miell Tirana" sh.a. u menaxhua nga nje staf i ri Inxhinjero-teknik nen drejtimin e Z. Roland Hysa. Fale aftesive shume te larta profesionale dhe njohjes shume te mire te perspektives se zhvillimit ekonomik te vendit prej tyre, u hartua strategjia e ristrukturimit dhe modernizimit te kesaj fabrike. Keshtu ne Vitin 2002 ne kete fabrike u be nje investim shume i fuqishem duke instaluar linjen teknologjike zvicerane te **markes BUHLER** me kapacitet **240 ton ne dite**, qe eshte teknologjia nr. 1 ne bote per prodhimin e miellit. Ky investim modern beri te mundur qe te shtohej jo vetem kapaciteti prodhues dhe asortimenti i prodhimeve tona, por mbi te gjitha te permiresohej shume cilesia e produkteve sipas normativave te CE.

Stafi drejtues Inxhinjero -Teknik i fabrikes sone eshte i gjithi i trajnuar jashte Shtetit nga specialiste zvicerane dhe gjermane dhe ka nje nivel shume te larte profesional. Linja teknologjike BUHLER me te cilen ne punojme realizon nje pastrim te plote te grurit nga pluhuri, guret, metalet, farerat e huaja te demshme etj. Kjo linje teknologjike, eshte terresisht e modernizuar dhe e izoluar nga ndikimi i ambientit te jashtem. Venia ne funksionim e saj eshte terresisht e kompjuterizuar. Prodhimet tona sot, jane shume te kerkuara jo vetem ne tregun vendas, por dhe ne eksport. "Miell Tirana" sh.a. mbulon 30 % te nevojave te tregut te brendshem per miell, duke dhene nje kontribut modest ne pakesimin e kuotave te importit te miellit, e per pasoje dhe ne uljen e cmimit te shitjes se miellit.

1.1.2. Te dhena te pergjithshme

Dritherat konsiderohet sit e parat bime qe njeriu i shfrytezoi per perdorim shtepiak. Ne shekuj dritherat kane pesuar ndryshime te dukshme dhe bimet qe kultivohen sot kane karakteristika te dallueshme nga ato primitive.

Dritherat jane bime vjetore, dimerore ose verore sipas periudhes se vjeljes. Vlera ushqimore e tyre lidhet me permbajtjen e larte te amidonit, permbajtja e yndyrnave eshte e ulet. Proteinat e pranishme jane ne sasi te vogel dhe kane nje mungese te disa aminoacideve kryesore, vecanerisht lizines.

Gruri eshte nje nder dritherat me te perdorur, I perket gjinise Triticum qe ndahet ne tre (3) grupe ne baze te numurit te kromozomeve:

- Grurerat diploid (2n-14)
- Grurerat tetraploide (2n-28)
- Grurerat heksaploide (2n-42)



Kjo procedure ka per qellim identifikimin dhe rregullimin e te gjitha aktiviteteve dhe/ose operacioneve te lidhura me programimin dhe ekzekutimin e punes ne Miell Tirana sh.a. Fusha e aplikimit lidhet me te gjitha administrimin e prodhimit te MIELL TIRANA sh.a.

Objektivi eshte ai i optimizimit te administrimit te prodhimit me qellim garantimin e respektimit te kerkesave te klientit, reduktimin e kostove te prodhimit dhe te blerjes, gjendjes se produkteve ne magazine dhe berjen eficente te flukseve te materialeve dhe ngarkeses se punes.

Duhet konsideruar qe programi i prodhimit eshte rrjedhim i nje plani te te ardhurave qe aprovohet ne fillim te vitit nga 1996, te cilet duke aprovuar nje plan te ardhurash, automatikisht, aprovojne edhe sasine e shitjeve pra edhe prodhimin.

Departamenti i Shitjeve dhe Marketing planifikon nje plan shitjesh te miratuar nga Drejtori i Pergjithshem. Sipas ketij plani Drejtoria e Prodhimit planifikon ne menyre fillestare prodhimin dhe ecurine e tij ne kohe. Po keshtu per te mbeshtetur prodhimin, pergjegjesit e Blerjeve planifikojne blerjet e lendeve te para dhe materialeve ndihmese.

1.1.3. Menyrat e punes (programimi i sherbimit; programimi i prodhimit)

Per cdo muaj Shefi i Prodhimit hartojne programin e punes mujore duke konsideruar:

- Objektivat e Kompanise
- Ecurin e muajve paraardhes,
- Ecuria e muajve perkates te viteve te meparshme
- Gjendja ne magazinin e lendes se pare te grurit/dritherit
- Gjendja ne proces neper sillose
- Gjendja e ambalazhuar ne magazine
- Planin e shitjeve
- Koha qe duhet per nje cikel prodhimi
- Sasine e prodhimit mujor, javor dhe ditor
- Nr I diteve te punes ne totalen e diteve te muajit.

Programimi i turneve te personelit:

Çdo Muaj Shefi i Prodhimit bashke me pergjegjesit e Reparteve pergatisin "TURNET JAVORE" ne baze te informacioneve te meposhtme:

- Informacione mbi lejet, semundjet dhe kerkesat e tjera te personelit,
- Plani i pushimeve vjetore,
- Sasia e produktit per tu prodhuar

"TURNI MUJOR" aprovohet me firme nga Shefi i Prodhimit dhe afishohet

PASTRIMI PARAPRAK

KONDITIONIMI

PASTRIMI PERFUNDIMTAR

BLUARJA

Pastrimi i kokres behet per te hequr papastertite, gure, fara te huaja etj. Ky eshte pastrimi i pare, qe i behet kokrras me te mberitur gruri ne silose.

Pastrimi i dyte behet perpara bluarjes. Ai largon cdo mbeturine tjeter me aspirim ose larje me H₂O. Kondicionimi sherben per te permiresuar bluarja. Behet nje lageshtim siperfaqesor i kokrrave dhe nje qendrim



per nje fare kohe ne te ftohte, ose behet nje lageshtim i thelle, ne brendesi te kokrres dhe nje qendrim per nje kohe ne temperatura me te larta.

Bluarja realizohet ne mullinje me nje ndertim specifik. Perdorim te madh kane gjetur mullinjte me cilindra, Cilindrat metalike vendosen horizontalisht dhe rrotullohen kundrejt njeri-tjetrit.

Cilindraj jane tre llojesh: cilindra me kanale te thella, te vendosura jo shume afer, bejne coptimin e kokrres ne copra relativisht te medha;

Cilindra me kanale me te holla te vendosura me afer, qe bejne nje copetim me te imet dhe Cilindra me siperfaqe te drejte, qe kthejne ne miell edhe grimcat e mbetura. Produkti i perftuar nga bluarja kalon ne planistra ne te cilat behet ndarja ne fraksione sipas madhesis se grimcave.

Klasifikimi i miellrave behet sipas sasise ne kg te miellit te perftuar nga bluarja e 100 kg grure (rrezja e miellit). Sa me i larte te jete ky tregues, aq me teper pjese te ashpra ka ne miell.

Pas sitjes mbeten krundet, te cilat gjejne perdorim si shtesa ne produkte te ndryshme, ose ushqim per kafshet.

Maturimi i miellit

Magazinimi i miellit sikurse edhe magazinimi i vete gruri, paraqet probleme qe duhen patur parasysh. Per te eliminuar insektet, perdoret centrifugimi ne aparate te posacem ose trajtimi me oksid etileni. Per te siguruar nje ruajtje te produktit per kohe te gjate, lageshtia duhet te jete 13 %, mbi kete vlere zhvillohen myqet dhe nen te ndodhe oksidimi lipidik.

Gjate ruajtjes ndodh nje permiresim i vetive te miellit (procesi quhet maturim) Gjate maturimi rritet elasticiteti i brumit dhe permiresohet vetia gazmbajtese.

Maturimi i miellit mund te pershpejtohet duke perdorur sasi te vogla te agjenteve maturues si bromati ose dyoksid i klorit. Si agent maturimi perdoret edhe acidi aksorbik, mendohet qe ky acid te jete aktiv pas oksidimit ne acid dehidroaskorbik nen ndikimin e enzimave te pranishem ne miell.

Duke konsideruar Planin e mesiperme te Prodhimit i komunikohet magazines se grurit sasia qe duhet te jete cdo dite ne mulli per bluarje.

Gruri thithet nga tuba me boshlek ajri te cilet e e dergojne ne mulli. Pasi bluhet dergohet ne silos per te pritur fazen e stazhionimit

Mulliri eshte i pajisur me site dhe me magnet permanent per te penguar hyrjen e mbeturinave solide dhe te metaleve ferroze.

Kompania ka nenshkruar kontrate me subjektet pekatese per terheqjen e himes.

Procesi verbalizohet ne modularet perkates ne te cilen shkruhen:

- Referenca e dates kur behet bluarja
- Lloji i grurit
- Pesha e Grurit ne hyrje/Dalje etj.

Pastrimi dhe Dizinfektimi i Reparteve

Pastrimi ka si qellim eliminimin e papastertise qe vjen nga mbetjet e perpunimit ose substanca te tjera te huaja.

Ndryshe nga sa me siper dizinfektimi eshte nje aktivitet qe nepermjet aplikimit te nje dizinfektuesi, ul pranine mikrobiologjike ne nivelet e sigurise dhe pastron elementet patogjene.

Dizinfektimi, aty ku kerkohet, kryhet gjithmone pas nje pastrimi te rregullt, dhe sjell dizinfektimin e lokaleve.

Veprimet qe kryhen per Pastrimin dhe Dizinfektimin jane:

1. Fshirje dhe larje,
2. Perdorim detergjentesh
3. Shplarje
4. Disfektim
5. Shplarje

Ne rastin e pastrimit, veprimtaria konsiderohet e perfunduar pas pikes se trete.

Regjistrimet

Per te regjistruar ekzekutimin e aktiviteteve te pastrimit dhe dizinfektimit, Miell Tirana sha. ka adoptuar per secilin repart dhe ambient Modularete, ku shenohen informacione ne lidhje me :

- Daten e trajtimit
- Pjeset qe kane qene objekt i operacioneve te pastrimit dhe disfektimit
- Produktet e perdorur
- Modalitetet operative te aktivizuara

Instruksionet

Me qellim qe te sigurohen kushtet higjenike te ambienteve, personeli perkates eshte i detyruar te respektojte instruksionet e meposhtme:

- Operacionet e larjes se ambienteve dhe te impianteve te kryhen cdo dite brenda nje orari ne fund te punes, per te evituar ngrirjen e papastertive mbi siperfaqe;
- Produktet per pastrimin dhe disfektimin duhet te perdoren ne perputhje me normat ne fuqi per kete fushe, me qellim qe te mos demtohet personeli, pajisjet dhe produktet ne perpunim;
- Duhet te ndiqen treguesit e dhene nga Prodhuesi ne lidhje me interesat qe duhen pergatitur per nje perdorim te rregullt te produktit;
- Ne rast se perdoren kontenitore te ndryshem nga ata origjinalet per tretesirat e pergatitur, keta kontenitore duhet te shenohen ne menyre te qarte me boje qe nuk fshihet;
- Produktet lares duhet te depozitohen ne zona te ndara, nga ato qe jane te percaktuara per pergatitjen dhe depozitimimin e produktit;
- Detergjentet dhe produktet e tjera disfektuese te cilat perdoren ne operacionet e pastrimit dhe disfektimit duhet te perdoren vetem nga personeli i autorizuar.

Burimet hidrike dhe energjitike

Kompania ka:

- dokumentacion ne lidhje me furnizimin e ujit (kontrate, license, fatura pagese ...) me Ujesjelles-kanalizime
- dokumnetacion ne lidhje me furnizimin me energji elektrike (kontrate, license, fature pagese) me Korporaten Elektroenergjitike Shqiptare

Shkarkimet hidrike

Kompania ka:



- ne funksion te aktiviteve qe kane shkarkime, ne kolektore publike ose tubacione (puseta)
- nje planimetri te rrjetit te shkarkimeve ne te cilen te tregohen pikat e shkarkimit.

Shkarkimet ne toke

Kompania nuk ka:

- dokumentacion ne lidhje me aktivitetin e mbledhjes se ujrave meteorike
- dokumentacion te projekteve ose te ndertimit te vaskave per mbledhjen dhe trajtimin e ujrave meteorike

Mbetjet

Kompania ka:

- dokumentacion per aktivitetet e asgjesimit dhe transportit te mbetjeve nga kompani te posacme; kontrate per shitjen e krrundeve per largimin e mbeturinave
- dokumentacion per regjistrimin dhe komunikimin e tipit dhe sasise se mbetjeve;

Zhurma

Kompania nuk ka:

- raport te vleresimit te zhurmes se brendeshme
- raport te vleresimit te zhurmes ne ambientin e jashtem

1.1.4. Te dhenat dhe vellimi i projektit

Respektimi i Planit te Menaxhimit Mjedisor do te mundesoj ne minimizimin ose parandalimin e ndikimit te ketij projekti ne menyre direkte apo indirekte ne mjedis. Duke vijuar me tej, risistemi i struktures ekzistuese te ketij aktiviteti dhe shfrytezimi do te ketë ndikime direkte ose indirekte ne aspektet social – kulturore dhe social – ekonomike të “status te kesaj zone te klasifikuar si per veprimtari komerciale dhe zhvillim te industrise se lehte. Ne tabelen e meposhime jane dhene treguesit kryesore tekniko-ekonomike te veprimtarise dhe objektit si me poshte shenuar:

Nr rendor	Emerimi i treguesve	Njesia e matjes	Sasia
A. Kapaciteti dhe permasat e ambientit depozitues			
1.	Kapaciteti perpunues	ton/dite	240
2.	Siperfaqja e pergjithshme e sheshit	m ²	13 210
3.	Siperfaqe ndertimit		3179
3.	Lartesi kati	m	4.5
B. Regjimi i punes			
1.	Ditet e punes ne vit	dite	265
2.	Numri i nderresave ne dite	nderresa	2
3.	Numri i oreve te punes ne nderrese	ore	8
C. Furnizimi me energji elektrike			
1.	Fuqia e instaluar	kW	100
2.	Ngarkesa e llogaritur	kW	200

1.2. Proceset kryesore te perpunimit te grurit/dritherit

Pas shkarkimit ne vendin perkates ne fabrike, gruri depozitohet ne silosa, nga ku fillon rrugen e tij te perpunimit ne fabrike.

Procesi i pare eshte procesi i pastrimit , ku gruri kalon neper nje sere makinerish qe sherbejne per pastrimin e tij dhe qe kryejne funksionin e largimit te lendeve te huaja, kokrrave te imta, kashtes, gureve, pluhurit ose papastertive te tjera. Gjate ketij procesi largohet 1 % e sasise totale e cila konsiderohet mbeturine dhe eliminohet duke u depozituar ne vendin e mbeturinave per tu larguar here pas here nga fabrika.

Procesi i dyte eshte procesi i larjes, ku gruri laget dhe i jepet sasia e duhur e ujit per tu pergatitur per te kaluar ne bluarje. Gjate ketij procesi, gruri mund te thithe rreth 2 % uje. Ne kete gjendje gruri qendron tek silosat e kondicionimit per rreth 10 – 12 ore ne varesi te llojit te grurit.

Procesi i trete eshte ai i bluarjes, ku gruri kalon neper makineri te ndryshme te cilat bejne te mundur transformimin e tij ne produkt kryesor sic jane miellra te ndryshem per buke, pica, byrek etj, si dhe ne nenprodukt qe eshte himja. Gjate ketij procesi, lenda e pare (gruri) humbet minimalisht 1 % nga sasia totale e tij si rezultat i avullimit dhe transformimit.

Sa me siper, sasia totale e firove qe perfshin te gjitha proceset e trajtimit te grurit duke filluar nga ngarkim-shkarkimi dhe deri ne ambalazhim eshte nga 1-2 %.

Ne procesin e prodhimit te miellit, vendoset se cfare lloj mielli dhe me cfare rreze do te prodhohet ne varesi te kerkesave te tregut. Keshtu ne qofte se do te prodhohet miell per buke (tip 500), rrezja e prodhimit do te ishte 70 % miell dhe 30 % hime, nese do te prodhohej miell integral, rrezja e prodhimit mund te shkoje deri ne 85 % miell dhe 15 % hime, nese do te prodhohej miell per pica dhe byrek, rrezja do te ishte 60 % miell 40 % hime dhe nese do te prodhohej miell per konfeksionim 1- 5 kg, rrezja e prodhimit do te ishte 50 % miell dhe 50 % hime.

Pas ketij procesi, mielli sipas llojit te tij, depozitohet ne silosat e miellit sikurse dhe himja ne silosat e saj. Si gjate procesit te prodhimit dhe gjate procesit te pushimit ne silosa, nga ana e laboratorit behen analizat dhe jepet ose jo, leja per tregtim.

Procesi i fundit eshte procesi i ambalazhimit i cili ka parasysh konfeksionimin e produktit (miellit), ose nenproduktit (himes), ne ambalazhet perkates, te cilat mund te jene thase 50 kg, 25 kg ose konfeksionim 1 kg. Ne perfundim te ketij procesi, malli eshte i gatshem per tu tregtuar.

1.3. Qellimi dhe karakteristikat fizike te objektit

Objekti eshte ndertese gjashte kateshe e ndertuar ne Vitin 1986 si ish N.SH.G.P. te Drithrave. Ka akses transporti me rruge tokesore te asfaltuara. Ndodhet ne ane te rruges automobilistike kryesore, te Unazes se Re, Bashkia Tirane (Njesia Bashkiake nr.6). Rrugica hyrese per ne objekt eshte e shtruar me asfalt.

Makinerite dhe paisjet jane te thjeshta, lehtesisht te perdoreshme dhe te sigurta ne pune. Jane me konstruksione te zakonshme, te komandimit me energji elektrike dhe me dore. Te gjitha paisjet dhe makenierite jane te importuara nga Zvicera dhe Italia. Pesha totale e te gjitha makinerive dhe paisjeve teknologjike te marra se bashku i kalon te 3000 kilogramet.

Te gjitha makinerite dhe paisjet vihen ne levizje me energji elektrike. Fuqia totale e instaluar rreth 100 kW. Aktiviteti zhvillohet ne nje objekt me siperfaqe totale sheshi 13 210 m², nga e cila rreth 3179 m² jane siperfaqe ndertimi dhe anekset e saj ne funksion te aktivitetit se bashku me pjesen e magazinimit. Muret jane ndertuar

me tulla, tavani me solete betonarme, monolite. DysHEMEJA shtruar me rezine per godina komerciale per te shmangur ndikimin nga zhurmat qe mund te shkaktohen ne kete aktivitet.

Parashikohet te perpunohet 10 ton ne ore ose rreth 240 ton ne dite sipas kerkesave. Objekti eshte e paisur me nje oxhak per dalje te tymrave ku eshte instaluar nje depluherezues i cili largon grimcat e pluhurit nga procesi i pastrimit te grurit para bluarjes, me lartesi qe do te dale rreth 2 metro mbi catine e godines me te larte te zones si dhe do te vleresohet drejtimi i erave te zones per te shmangur ndikime te ndonje rajon tjeter aty prane objektit.

1.4. Kerkesat mbi perdorimin e tokes

Ky objekt eshte ndertuar ne nje shesh ne pronesi vetiake te pronarit te vet, me siperfaqe totale sheshi rreth 13210 m².

Objekti ne fjale ka permasa te vogla, dhe si i tille volumet e ndertimit nuk kane dashur siperfaqe shtese per ngritje te ndonje kantjeri gjate ndertimit sepse sheshi ne dispozicion eshte i mjaftueshem dhe nuk ka shkaktuar demtime ne mjedisin rrethues.

Ne sheshin e ndertimit bejne pjese:

-Godina me anekset e brendshme perkatese dhe nje shesh i lire per qendrim te perkohshem te automjeteve te sherbimit.

-Ka gjithashtu nje shesh te lire te gjelberuar, ne pjesen e prapme te godines.

Gjate kohes se operimit te objektit nuk krijohen demtime qe mund te benin si sheshin dhe godinen te parikuperueshme dhe te paperdoreshme per qellime te tjera, pasi mbetjet qe shkarkohen nga ky objekt jane te natyrave ushqimore dhe ne sasira shume te vogla.

Mbetjet e lengeta, nepermjet kanaleve te brendeshme kalojne, ne kolektorin kryesor te qytetit, i cili kalon fare prane, ne ane te rruges automobilistike e asfaltuar. Nuk ka shkarkime te lengeta, qe mund te filtronin ne toke dhe te perbenin kerccenim per demtimin e ujrave nentokesore.

Ne rast se ky aktivitet, per arsye te ndryshme, nderpritet ne nje te ardhme, i gjithë sheshi eshte plotesisht i perdorshem per qellime te tjera. Po ashtu godina mund te perdoret per cdo veprimtari tjeter qe i pershtaten permasat e saj pa patur asnje dyshim per ndonje mbetje te demshme nga veprimtaria paraardhese. Sheshi i lire eshte gjithashtu i pershtatshem per mbjellje bimesh te ndryshem, lule decorative, bar te kultivuar ose gjithcka tjeter ne permiresim te mjedisit rrethues.

Lendet ndihmese kryesore (nuk kane veti demtuese per mjedisin) Energjia elektrike meret nga rrjeti i zones se i zones, Fideri i Kasharit. Rrjeti ka provuar deri me sot se nga fillimi i aktivitetit nuk ka patur probleme me zonen ne te cilen ka ushtruar aktivite komerciale. Uji merret nga ujesjellesi i qytetit, qe kalon rreth 10 metra larg. Perdoret per larje te thjeshta dhe per ambientet higjeno sanitare, pasi procesi nuk kerkon perdorim te ujit.

Mbajtja paster e ambientit ne afersi te rruges automobilistike nga mbeturinat e ndryshme qe mund te hidhen nga ky objekt. Ne rast se ne nje te ardhme do te lind nevoja per sigurimin e nje motor-gjeneratori elektrik ai do te zgjidhet i tipit me silencator. Do ndertohet oxhak me permasa me te larta nga 2-3 m ne funksion te objektit me te larte te zones duke vleresuar trendafilin e eres.

1.5. Pjesa e pergjithshme dhe transporti

1.5.1. Vendndodhja e sheshit te ndertimit

Per ndertimin e ketij objekti, sic eshte permendur edhe me siper, eshte konsideruar nje mjedis me siperfaqe 3179 m², ne kuoten ±0,00 te objektit. Pozicioni i tij favorizon mundesine funksionale te ketij procesi pune me ndikim minimal te impaktit mbi popullat nga vete pozicioni ne zone.

1.5.2. Plani i pergjithshem dhe kompozimi i objektit

Vendosja dhe kompozimi i fabrikes eshte realizuar duke konsideruar teknologjite e mundeshme te pershtatshme per objekte te ketij karakter . Ne objektin e detyres, vendosja per kete ka qene harmonizimi optimal i aktivitetit me nje siperfaqe te shfrytezuar maksimalisht. Mbi keto synime eshte realizuar shtrirja ne plan e objektit, paraqitur kjo edhe ne pjesen grafike perkatese.

1.5.3. Transporti i brendshem

Ne kompozimfn ne teresi te objektit eshte patur parasysh edhe mundesia e manipulimit sa me te pershtatshem te mjeteve qe fumizojne si dhe te atyre qe fumizohen per subjekte te ndryshme lidhur .me kerkesat qe kane.

1.6. Sistemet inxhinierike

1.6.1. Furnizimi me uje dhe kanalizimet

Furnizimi me uje: Furnizimi me uje te pijshem dhe per nevoja:higjeno-sanitare te fabrikes do te zgjidhet ne teresi me objektet e shoqerise "MIELL TIRANA"sha si dhe ne harmonizim me grupin e objekteve te tjere qe ndodhen ne kete zone sipas rekomandimeve te normave dhe kushteve teknike .

Kanalizimet: Te gjitha ujrat qe dalin nga shfrytezimi i objektit dhe shkarkimeve higjeno-sanitare, sistemohen ne kolektoret kryesore duke i disiplinuar ata dhe duke kaluar neper vaskat e dekantimit para se te futen ne tubacionet e kanalizimeve te ujrave te ndotura urbane.

1.6.2. Furnizimi me energji elektrike dhe nderlidhja

Furnizimi dhe shperndarja e energjise elektrike: Furnizimi me energji elektrike i objektit te fabrikes do te realizohet permes zgjidhjes qe i eshte dhene objekteve te tjera qe ndodhen ne kete zone.

Fuqia e instaluar eshte rreth 50 kW. Per kete jane parashikuar priza ne te dy krahet e objektit referuar hyrjes ne te. Paneli i shperndarjes se tensionit te ulet eshte menduar te jete ne ambientin qe eshte parashikuar per objektin ne teresi.

1.6.3. Ndricimi

1.6.3.1. Ndricimi i brendshem

Ndricimi zgjidhet ne kompleks me objektet e planimetrise ne kuoten +0,00. Gjithashtu ne percaktimin e fuqise se ndricimit te nevojshem jane patur parasysh normat dhe kushtet teknike per objekte te tille.

1.6.3.2. Ndricimi i jashtem

Duke patur parasysh regjimin e punes se objektit ne teresi eshte parashikuar ndricimi i vendeve ku kryhen manipulime te ngarkim-shkarkimit te mallrave nga mjetet transportuese. Gjithashtu per qellime te ruajtjes si

dhe te manovrimeve te mjeteve levizese brenda territorit te kompleksit te ndertimeve, eshte parashikuar ndricimi nga jashte ne teresi.

1.6.3.3. Nderlidhja

Nderlidhja e fabrikes dhe te objektit ne teresi (magazina dhe zyra), realizohet me telefon fiks nepermjet linjes qe kalon aty prane. Gjithashtu nderlidhja realizohet edhe me telefon celular.

1.7. Mbrojtja e objektit

1.7.1. Mbrojtja nga renia nen tension

Per vete karakterin teknologjik te objekteve te ketij lloji dhe rrezikshmerine qe paraqesin ato, eshte parashikuar edhe mbrojtja e impiantit nga renia nen tension. Kjo eshte realizuar pare ne kompleks me objektet e tjera te kompleksit .

1.7.2. Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike

Gjithashtu pika e shitjes eshte pare edhe ne drejtim te mbrojtjes nga rreziku i shkarkimeve atmosferike. Per kete sistemi i mbrojtjes eshte i perfshire me ate te objekteve te shoqerise.

1.7.3. Mbrojtja nga zjarri

Sipas kushteve teknike dhe normave te projektimit per mbrojtjen nga zjarri, per pikat e shitjes me shumice per objekte te tille nga madhesia, prania e impiantit stacionar zjarrfikese nuk eshte i detyrueshem.

Megjithate, gjate hartimit te projektit problemet e mbrojtjes nga zjarri kane qene te rendesishme dhe te perfshira ne konsideraten e grupit te projektimit. Pervec masave kundra zjarrit, ne fabrike do te merren keto masa:

- a. Vendosja e disa mjeteve zjarrfikese.
- b. Kompozimi i hapsirave dhe rrugeve brenda sheshit lejon mundesine e manovrimeve te shpejta. Po keshtu, gjeresite e korridoreve dhe te rrugeve jane te mjaftueshme per evakuime ne raste emergjence. Sheshet dhe rruget per qark impiantit mundesojne afrimin e lehte te mjeteve zjarrfikese.
- c. Nuk jane perdorur materiale qe ndizen lehte.
- d. Instalimet elektrike jane realizuar brenda normave dhe kushteve per mbrojtje ndaj zjarri.
- e. Ne vende te dukshme, objekti eshte i pajisur me anen figurative me te cilat ndalohet perdorimi i cdo mjeti qe perben burim zjarri.
- f. Jane vendosur dy dyer per te krijuar mundesi dhe lirshmeri veprimi ne raste te papelqyera te renies se zjarrit.

1.7.4. Organizimi menaxherial i punes

Per drejtimin dhe shfrytezimin e fabrikes, eshte menduar te sherbeje nje punonjës. Kjo eshte percaktuar duke konsideruar regjimin e punes si dhe karakterin e sherbimit ne te

Hyrje

Subjekti “Miell Tirana” me seli ne rrugen “Unaza e Re e Tiranës”, Blv Teodor Keko”, Tirane, paraqet kete kerkese per vendim AKM per:

Aktiviteti: Fabrike per prodhim te miellit

Vendodhje: Fabrika e Miell Tirana, rrugen “Unaza e Re e Tiranës”, Blv Teodor Keko”, Tirane

Objekti ndodhet ne nje nje objekt ekzistues lsh Fabrika e Miellit Tirana. Objekti nuk cenon rruget dhe trotualet duke respektuar dhe kondicionet urbanistike. Parashikohet rigjallerimi i zones e cila ka filluar te ndertohet me objekte tregtare te reja por dhe ne funksion te objekteve magazina ekzistuese dhe krijimi te hapësirave te gjelberta.

Praktikat e mira të higjenës në kete fabrike, është përshkruar dhe është definuar me Kodin e Codex Alimentarius Parimet e Higjenës Ushqimore CAC/RCP Kor.3 (1997), e ndryshuar në 1999. Informacioni i mëposhtëm është bazuar në parimet e plotësuar nga Legjislacioni i BE dhe në praktikë.

Rregulloret e PMH i adresojnë çështjet që lidhen me mbajtjen e të dhënave, kualifikimin e stafit, higjenën publike, verifikimin (kontrollin) e pajisjeve dhe shqyrtimin e ankesave. Ne si operator do të aplikojmë praktikat higjenike me te mira te kerkuara si programi i permiresimit te operimit nga ana e subjektit Miell Tirana të caktuara në këtë kapitull për të:

- Siguruar ushqim i cili është i sigurtë dhe i përshtatshëm për konsum;
- Siguruar që konsumatorët kanë informacion të qartë dhe lehtë të kuptueshëm, me anë të etiketimit dhe mjeteve tjera të duhura, për të iu mundësuar atyre që të mbrojnë ushqimin e tyre nga kontaminimi dhe rritja apo mbijetesa e patogjenëve të krijuar në ushqim me anë të ruajtjes, procesimit dhe përgatitjes në mënyrën e duhur;
- Të kenë besimin tek ushqimi i tregtuar.

Ky program është përgatitur per kete qellim, por gjithashtu bazuar në rregullorën e higjenës së ushqimit të aktit ligjor të vendeve te BE si dhe është adaptuar dhe përshtatur mënyrës së përgatitjes dhe shërbimit të ushqimit në vendin tonë.

Kush duhet të marrë përgjegjësi për Programin e permiresimit te operimit ne fabrike, ai do te jete “Menaxheri” i cili është përsonei përgjegjës në përditshmërinë e biznesit, i cili duhet të punojë me këtë program.

Përdorimi i PPO do te ndihmojë që të:

- Të punoj me rregullat e reja të higjenës,
- Tregoj çka bëni që të përgatitni ushqim të sigurt,
- Të trajnoj stafin,
- Të mbron reputacionin e biznesit tuaj,
- Të përmirësoni biznesin tuaj, p.sh duke shpërdoruar më pak ushqime dhe ndikuar me pak ne mjedis.

Kërkesat higjiene - sanitare gjatë prodhimit të miellit.

Në “fabriken e miellit” dhe në repartet e përpunimit të dritherit për krijimin e kushteve të përshtatshme të punës duhet të:

- zbatohen rregullat higjiene-sanitare të linjës dhe reparteve;
- zbatohen rregullat e higjenës vetjake dhe e veshjes nga punëtorët;
- njihen standardet e higjenës për njesine e prodhimit te miellit.

Repartet dhe vendet e punës dhe vendet ku ruhet mielli e prodhuar duhet të jenë gjithmonë të pastra. Në reparte nuk duhet të ketë pluhura e sidomos pluhura nga mielli, pasi dëmtohet shëndeti i punëtorëve. Për këtë qëllim, përveç pastrimit të makinerive, vendeve të punës e mjediseve përreth, është i domosdoshëm filtrimi dhe ndërrimi i ajrit në repartin e përgatitjes së miellit, në atë të përgatitjes së brumit etj. Linja e prodhimit duhet

të dezinfektohet sipas një grafiku periodik të rregullt. Punëtorët duhet të jenë të pajisur me librezë shëndetësore, të jenë të veshur me uniformë pune të pastër sipas rregullores së brendshme të njesise se prodhimit te brumit.

Planet për garantimin dhe Kontrollin e cilësisë

Të gjitha fabrikat deri tani kanë mikro-dozatorë që përdoren për shtimin e përmirësuesve në miell dhe shumica preferojnë ti blejnë nga furnizuesit e tyre tradicionalë. Furnizuesit e këtyre fabrikave janë plotësisht në gjendje të prokurorinë mikro-dozatorët e kërkuar dhe shumica e furnizuesve të aditivëve të miellit i gjejnë burimet e premiksit (përzjerje e parapërgatitur), nëse u kërkohet, si shërbim për klientët e tyre.

Objektivat e çdo sistemi janë:

- Sigurimi i informacionit se çfarë duhet bërë për të garantuar plotësimin ekërkesave ligjore dhe ato të konsumatorit.
- Rritja e njohurive mbi procedurat eregjistrimit të të dhënave dhe monitorimi që duhet të vendosen për të qënë në përputhje me skemën e garantimit të cilësisë.
- Rritja e kuptimit për elementët e ndryshëm të procedurave të inspektimit qëduhet të ndiqen.

Sistemi i kontrollit dhe monitorimit

Garantimi i cilësisë/kontrolli cilësisë është tërësia e masave të marra me objektivin që të garantohet se produktet ushqimore janë të cilësisë së kërkuar për përdorimin e caktuar në nivel konsumatori. Është e rëndësishme të sigurohet që proceset e kontrollit të cilësisë të përputhen me rregullat për fortifikimin e ushqimeve.

Protokolli i Garantimit të Cilësisë

Është e rëndësishme të kontrollohet rregullisht performance e mikro-dozatorëve. Shtimi i shumë pak përzjerje fortifikuese është kundër rregullave dhe nuk do të jepte për konsumatorin përmirësimin ushqimor të pritshëm. Shtimi i sasive të tepërta përzjerje fortifikuese do të dëmtonte financiarisht. Mbidoza e përzjerjes fortifikuese nuk ka të ngjarë të shkaktojë ndonjë dëmtim për konsumatorin. Kjo për arsye se produktet e miellit, p.sh. miell do të ketë një shije tjetër që konsumatori nuk do ta pëlqejë. Kjo ndodh në rastet kur nivelet e dozave janë shumë poshtë atyre që kanë mundësi të shkaktojnë helmim.

Nëse konsumatori nuk do të dëmtohet, megjithatë ai do të mërzitet dhe konsumatorët e mërzitur zakonisht nuk bëhen më konsumatorët e mëparshëm, si rrjedhim biznesi pëson humbje. Fabrikat(linja e prodhimit) qe duhet te merret ne konsidetat ne pergjedhjen e miellit) duhet gjithashtu të kenë parasysh rëndësinë e marrjes së mostrës që trajtohet tek Kontrolli Ushqimor, për të dyja rastet, si kur merren mostra nga vetë ata edhe kur marrin mostra inspektorët e ushqimit. Kini parasysh se në ligjin për ushqimet thuhet që fabrika duhet ta shoqërojë inspektorin gjatë kontrollit të tij, të sigurohet se është marrë një mostër sipas ligjit dhe të marrë masat që vetë ata të marrin një cope të mostrës për ndonjë verifikim të mundshëm në laboratorë të certifikuar.

Trajnimi

Planet për Garantimin e Cilësisë dhe Kontrollin e Cilësisë janë të përgjithshëm dhe duhet të modifikohen sipas situatave të veçanta në kete veprimtari. Evidentimi se ku do të merret në kete njesi mostra përfaqësuese është e një rëndësie të veçantë sic vleresohet dhe trajnimi i stafit per nje miremenaxhim konform kerkesave ligjore ne fuqi.

Monitorimi

Monitorimi dhe zbatimi i ligjislacionit mund të kryhen me efektivitet duke shfrytëzuar rrugët alternative të kimisë së lëngët - konkretisht nëpërmjet precipitimit në letër – që mund të kontrollojë shumë shpejt miellin e grurit të fortifikuar që hyn në treg. Detyre e institucioneve kontrolluese se per subjektin ne vleresim eshte jashte kopetencave te tij.

Pothuajse në çdo rregull dhe standard për fortifikimin përmenden jo vetëm përbërësit e parashikuar që mund të shtohen, por edhe nivelet minimale dhe maksimale të këtyre përbërësve. Parashikimi i niveleve minimale është llogjike dhe në mënyrë të veçantë llogaritet si një tolerancë në përqindje të veçantë në nivelin e parashikuar me ligj; ndërsa parashikimi i nivelit maksimal si tolerancë ekuivalente mbi nivelin ligjor është jollogjik, për mendimin e konsulentëve.

Së pari, dihet se përmbajtja natyrale e mikroelementëve ushqyes ndryshon shumë - ndoshta më shumë se sasia që shtojnë shumica e premikësve të fortifikimit. Fakti që çfarë ne shtojmë i jepet konsumatorit më bio se përmbajtja natyrale është ajo çka këtu nuk shkon.

Së dyti, rregullat ose standartet rrallë kanë parasysh gabimet analitike dhe ato që bëhen në marrjen e mostrave dhe që janë të qënësishëm në testimet për qëndrueshmërinë në nivelet ppm(pjesë per million) të cilët përdoren në programet për fortifikimin e ushqimeve.

Për të mbështetur argumentin e mësipërm konsulenti do të referohej një studimi i kryer në ku tregohet se laboratorët e akredituar botërisht (për vitamina dhe analiza minerale) dhe laboratorët e tjerë të prodhuesve të ndryshëm të premiksit, etj. kanë arritur konsensusin e duhur (koeficienti tipikë i luhatjes-variacionit(CV) ndërmjet laboratorëve ishte 10-12%, ndërsa koeficienti luhatjes brenda çdo laboratorit është më i ulët) për lëndët përbërëse të premiksit për fortifikim si kur janë në formë orgjinale edhe kur janë të falsifikuar) por vetë këta laboratorë nuk mund të arrijnë konsensusin kur koeficienti variacionit luhatjes është 40%, brenda çdo laboratorit CV ishin më të ulët por më e lartë se ajo e arritur me premiks) për produkte të gatshëm, homogjenë të prodhuar në laborator si në formë orgjinale dhe të falsifikuar. Sidoqoftë, shkaqet për mosmarrëveshje si brenda një vendi edhe midis vendeve të ndryshme në lidhje me analizën e produkteve të fortifikuara janë evidente.

Së treti, laboratorët rrallë matin përbërësit faktikë të shtuar, zakonisht masin përmbajtjen totale të një mikroelementi ushqyes të caktuar. Hekuri, për shëmbull, shpesh matet në total duke përdorur thithjen atomike nga një mostër hiri dhe nuk bëhen matje për përbërësit e veçantë (dhe për disa përbërës kjo nuk është e mundur); ose matet e gjithë folata dhe nuk matet vetëm acidi folik (vetëm kohët e fundit është gjetur një metodë me anën e së cilës matet veçmas acidi folik i shtuar). Kjo mungesë saktësie e shoqëruar edhe me përmbajtjen variable të elementëve esenciale

- që është diçka e panjohur për çdo mostër të veçantë. Konkretisht në ligjin për ushqimet konsideroheni fajtor deri sa të provohet pafajësia që do të ishte shumë e vështirë të realizohej bazuar në kiminë analitike. Caktimi i një maksimumi si tolerancë ekuivalente maksimale për nivelet që parashikohen nuk mbështetet gjithashtu mbi baza shkencore të njohura - është thjesht një vendim arbitrar i cili nuk mund të ketë vend në një dokument ligjor. Nuk është e nevojshme të caktohen nivelet maksimale, ato duhet të vendosen mbi baza shkencore si një pranim maksimal i sigurisë ushqimore siç përcaktohet edhe nga WHO, etj.

Gjithashtu, rregullat dhe standartet duhet të përcaktojnë protokollet për marrjen e mostrave që duhet të ndjekin inspektorët kur marrin mostrat për testimet e përputhshmërisë.

Pothuajse të gjitha rregullat dhe standartet shfrytëzojnë gjerësisht Kodeksin Alimentarius(Kodeksi ushqimor). Në fakt ato janë normalisht kodekse e dokumenta më të mire. Megjithatë këtë lidhje të fortë me Kodeksin, Udhëzuesit për marrjen e mostrave (CAC/GL 50:2004), botuar nga Kodex, shumë shpesh injorohen totalisht nga autoritetet sepse ata e parashikojnë marrjen e mostrës nga rrënja katërore e numurit të paketave në një dërgesë.

Një sistem efektiv për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë është vital për ruajtjen e cilësisë të artikujve ushqimorë të fortifikuar ndërsa ata shpërndahen në treg. Procedurat standarte për të siguruar që grure për miell është fortifikuar siç duhet përfshijnë:

□ Përdorimi i paisjeve dhe njësive të peshimit cilësore dhe të përshtatshme.

- Mbajtja korrekte e të dhënave të inventarit.
- Manipulim dhe magazinim i përshtatshëm.
- Mbajtja korrekte e dokumentacionit të prodhimit.
- Kryerja e inspektimeve të rregullta të paisjeve, një here në çdo turn 8-10 orësh.
- Kryerja e analizave të rregullta të mostrave për të verifikuar se janë fortifikuar siç duhet.
- Amballazh dhe etiketa të përshtatshme.
- Shfrytëzimi dhe ndjekja e procedurave strikte për qarkullimin e rezervave për të parandaluar që rezervat e vjetra të humbasin potencën e tyre dhe të përputhet me kohëzgjatjen e afatit të skadimit. Për këtë qëllim rekomandohet të shfrytëzohet dhe implementohet sistemi FIFO(First in, first out - Metodë për vlerësimin e rezervave - malli që futet i pari del i pari nga magazina-).
- Mbani shënime për blerjen e miellit;
- Mbani shënime për rezervat dhe përdorimin e tij;
- Mbani shënime për përdorimin e sasive të miellit të fortifikuar për miell;
- Mbani shënime mujore për sasitë e që përdoret çdo muaj. Këto rekorde duhet të korrespondojnë me shënimet për prodhimin mujor;
- Merrni masa që të monitorohen të gjitha fazat kritike të procesit të prodhimit për të siguruar që niveli korrekt i dozave do të mbahet dhe vazhdojë nëpërmjet këtyre masave:
- Kontrolli të paktën një here në turn (më rrallë nëse blihen mikro-dozatorë të sigurt) për të siguruar që ata të japin nivelet korrekte të dozave. Kjo bëhet duke matur peshën e përzierjes fortifikuese e shkarkuar gjatë një kohe të caktuar (1 ose 2 minuta) dhe të krahasohen këto matje me peshat e planifikuara.
- Kryerja e kontrolleve vizuale të paktën dy here në turn për tu siguruar se përzierjet janë përdorur dhe se nuk ka ndodhur asnjë bllokim dhe për këtë të mbahen shënimet përkatëse.
- Kryerja e testeve për njollat e hekurit në miellin e miellit në fillim dhe në fund të çdo regjim prodhimi për tu siguruar se produkti ka marrë dozat korrekte.
- Të gjithë këtë dokumentacion viheni në dispozicion për tu inspektuar nga autoritetet e monitorimit, të cilët përgjigjen për monitorimin e programit të përmirësimit të operimit nga AKU dhe për kryerjen e inspektimeve dhe implementimin e sistemeve të monitorimit për të gjithë produktet ushqimorë të fortifikuar.

1.8. Vleresim i ndikimit ne mjedis dhe masat e marra per minimizimin e impaktit mjedisor

Ne vijim paraqesim te dhenat per ndotesit ne mjedis dhe masat per zvogelim e ndotjes dhe monitorim te tyre.

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejt/te tertorte/te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij procedure eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky projekt ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njeren prej fazave kryesore ne ate te operimit. Nuk marrim ne konsiderat fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoje te jete i tille. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Efektet e mundshme nga aktiviteti do te vleresohen ne menyre te pergjithshme ne kete raport paraprake draft per fazen e konsultimit.

Ndikimet kryesore

Ne cilesine e ajrit.

Faza e operimit: Ndikimet kryesore ne kete faze do te shkaktohen nga:

- Nga pajisjet operuese gjate procesit te punes:
 - Nga pajisja e perzierjes se miellit me ujin dhe nga peshorja nuk ka emetime ne ajer te asnje lloj perbersi pasi vete procesi nuk perben perpunim ose ndryshim gjendje fiziko-kimike te materialeve.
 - Emetimet ne ajer mund te shkatohen nga gazrat e motoreve me djegie te brendshme te makinerive te prodhimit te energjise alternative sic mund te jete gjeneratori.
 - Gjithashtu vlen te permendet edhe avujt qe emetohen ne ajer nga procesi i pjekjes. Emetim ky i pa demshem per shendetin dhe mjedisin rrethues.

Emetimet ne ajer u theksua me siper qe do te prodhohen nga djegia e lendes djegese por mund te themi se niveli i shkarkimeve do te jete i ulet, pra ne nivele te pa perfillshme, kjo vjen si rezultat se gjeneratori do te perdoret ne raste shume te vecanta kur ka avari ne sistemin e furnizimit me energji elektrike, pasi perdorimi i gjeneratorit rriht koston dhe ul cilesine e energjise elektrike duke qene i rrezikshem per pajisjet ne ambientin e punes.

Vibrimi dhe zhurmat.

Faza e operimit: Disa burime qe mund te shkaktojne zhurmat dhe vibrimet jane te paraqitura ne menyre te permbledhur si me poshte:

- *Si pasoje e punes se pajisjeve ndikime te vogla mund te kete elektromotori i sistemit te aspirimit ndikim jo shqetesues per banoret, pasi nga inspektimi ne terren nuk ishte shqetesues edhe per punonjesit)*
- *Te shkaktuar nga prania e punonjesve ne ambientin e punes: Prania e punonjesve do te kete ndikim ne rrijte te nivelit te zhurmave nga bisedat dhe veprimet e tyre. Ndikimi i tyre do te jete teper i ulet si dhe duke pasur parasysh edhe masat e marra per eleminimin e zhurmave dhe vibrimeve te mundshme.*

Zhurma e krijuar nuk do te jete e ndryshme nga zhurma qe shkatohen ne nje shtepi banimi, mund te theksojme faktin se ndotja akustike do te jete ne nivele me te ulta pasi ne kete ambjent jane marre masa per humbjen e zhurmave (izolimin akustik dhe termoizolim).

Nuk do te shkaktohet ndotje akustike e mjediseve te banuara pasi pervec pajisjeve te reja dhe moderne jane marre masa edhe per termoizolim.

Ne toke.

Faza e operimit: Nuk ka ndikime ne toke pasi nuk ka edhe punime me token, pasi objekti eshte i ndertuar dhe i lidhur me infrastrukturen e zones ekzistuese.

Ne ujerat nentokesore.

Faza e operimit: Nuk ka ndikime ne ujerat nentokesore pasi nuk ka edhe punime me nentoken, pasi objekti eshte i ndertuar dhe i lidhur me infrastrukturen e zones.

Ne flore dhe faune dhe ndikimi nderkufitar.

Gjate fazes se montimit+ operimit: Nuk ka ndikime ne ne Flore dhe Faune pasi nuk ka edhe punime me ambientin, pasi objekti eshte i ndertuar dhe i lidhur me infrastrukturen e zones.

Mbi trashegimine arkeologjike, kulturore dhe historike.

Gjate fazes se funksionimit: Nuk do te kete as ndikime te tilla

Ndikime te tjera.

Faza e operimit:

- a) ***Drita dhe nxehtesia.*** Nxehtesia e prodhuar nga pajisjet, gjeneratore, etj mund te shkaktojne ndotje termike te mjedisit perreth si dhe mbingarkese te rretit te energjise elektrike ne nje nivel shume te ulet, por keto ndikime do te merren parasysh gjate vendosjes se ventilatorit per te shmangur dhe mbi nxeheje te makinerive. Ndikim do te kete e nga ndricimi mjedisit perreth. Projektimi eshte realizuar me eficence ku cdo makineri eshte e shkalles A per konsum te energjise Ku projektim eficient do te sjell ulje te konsumit te energjise elektrike ne teresi.
- b) ***Rrezatimi.*** Nga makinerite nuk do te kete ndikim ne mjedis nga rrezatimi, sepse ne asnje ambiente pune nuk do te perdoren materiale qe rrezatojne ne mjedis dhe qe kane impakt negative dhe per vete mjedisin human(mbi punonjesit).
- c) ***Mbetjet e prodhuara.*** Mbetjete ngurta te prodhuara nga punonjesit do te jene si; Mbetjet e ngurta si plastike, shishe qelqi, materiale letre, mbetje organike, etj. Kapaciteti do te jete ne nivele te ulta si dhe do te ndiqen politika me efikasitet per menaxhimin e ketyre mbetjeve te ngurta urbane qe ne burim ku llogaritet nje sasi e lendes organike qe do te depozitohet ne kontenjer e zones rreth 0.4kg/dite ndersa mbetjet e ngurta te riciklueshme si me siper do te keni nje sasi totale 0.4kg/dite e cila do te riperdoret nga kompani te licensuara dhe te certifikuara per te realizuar kete proces..
- d) ***Ndikime indirekte.*** Ndikime te tjera indirekte ky studim do te kete:

- Ne lidhje me konsumimin e lendeve djegese nga gjeneratori, te energjise elektrike dhe te ujit per konsum. Mungesa e energjise elektrike pervec shume problemeve te ndryshme qe po perballet Korporata Elektroenergjitike(KESH-e), nje nga shkaqet eshte shtimi i kerkesave gjithmone e ne rritje te popullise.

MASAT LEHTESUESE

Arkeologjia dhe trashegimia kulturore

Per shkak te distances shume te larget ndermjet studimit te propozuar dhe zonave me trashegimi kulturore, masat lehtesuese nuk jane kerkuara dhe nuk jane propozuar.

Hidrologjia, ujrart siperfaqesore dhe nentokesore: Nuk jane te nevojshme pasi nuk ka ndikim

Habitati dhe biodiversiteti: Nuk jane te nevojshme pasi nuk ka ndikim

Cilesia e ajrit.: "Ndotja" ne cilesine e ajrit nga ererat gjate procesit te pjekjes dhe nga avujt eshte eliminuar pothuajse plotesisht pas investimit te kryer nga investitori per percjelljen e tyre deri ne lartesine mbi nivelin e objektit me tuba metalike xingato dhe nepermjet nje elektromotori per largimin e tyre nga ambjenti i punes.

Zhurmat: Jane marre masa edhe per eliminimin e zhurmave ndonese nuk jane shume te nevojshme fale pajisjeve te reja dhe te certifikuara. Sic permendet edhe me larte izolimi me material termoizolues i tavanit dhe mureve.

Masa lehtesuese te tjera te kerkuara

Do te behet nje menaxhim sa me me eficient te energjise elektrike.

Lyerja dhe rregullimi i fasades se jashteme duke krijuar nje pamje me te kendshme

Do te behet menaxhimi i mbetjeve te ngurta, te cilat do te jene; lende te aballazheve, letra-kartona, qelqe, alumine si dhe lende organike te prodhuara nga punonjesit ku keto mbetje do te depozitohen ne vendin e caktuar nga Bashkia Tirane, ku firma do te marre masa per menaxhimin e ketyre mbetjeve te ngurta, do te vendosen ne kosha selektive(nese do te filloje zbatimi i projektit te menaxhimit te mbetjeve) ku me pas do te transportohen nga automjetet e pastrimit te qytetit per ne vendet e caktuara prej tyre. Mbetjet e ngurta urbane te prodhuara, do te depozitohen ne kosha te percaktuar nga Bashkia Tirane, ku do te jete nje sasi prej 0.8kg/dite total me mbetjet e ricikluara. Per kete projekt do te ndertohet xhepi i kontenerit sipas kushteve te caktura nga Drejtoria e Pastrimit te Territorit.

Do te tokezohe rrjeti elektrike per te shmangur ndonje shkarkese elektrike, konform kushteve teknike,

Do te merren keto masa kryesore te mbrojtjes kundra zjarrit. Do te perdoret uji i marre nga rrjeti i shperndarjes se ujit apo nga rezervuaret qe do te vendosen ne objekt per rastet e emergjences (zjarret e mundshme qe mund te bien). Rrjeti per shuarjen e zjarreve duhet te jete i lidhur me rrjetin e ujit perkates. Pervec kesaj ne ambjentin e punes ka ekzistuese edhe bombula me gaz ne te ardhem nese vleresohet si lende djegese e cili ul koston e prodhimit si per fikjen e zjarrit ne raste emergjence.

Masa per sigurimin teknik dhe mbrojtja ne pune

Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk do te sjelle rrezikshmeri per aksidente, duke qene se nuk do te kete mbajtje ose perdorim i substancave te rrezikshme. Gjithashtu te gjitha pajisjet funksionojne nepermjet rrymes elektrike.

Per nevojat e punonjesve ambjenti eshte paisur me ambjent higjenosanitar per nevojat e personelit por edhe ne ambjentin e punes ne menyre qe te mbahet paster ambjenti dhe enet e prodhimit te miellit.

Detyrimet e punedhenesit: Punedhenesi vete ose nepermjet drejtuesit teknik qe ka te punesuar, duhet t'ju beje te ditur punemarresve:

1. Procesin e punes ne frontin ku punon.
2. Pajisjet dhe makinerite qe perdoren dhe menyren e perdorimit.
3. Shkaqet e aksidenteve dhe masat dhe per menjanimin e tyre.

4. Ndhimen e pare shendetesore.
5. T'u krijoj punonjesve te mira pune dhe jetese, si:
, ushqim falas dhe fjetje kur punonjesit vijne nga larg vendbanimit te tyre.
6. Ndalohet riparimi i avarive, grasatimi dhe punime te tjera kur makinerite jane ne pune.
7. Gjithashtu duhet tu njohje rregulloren e mbrojtjes kundra zjarrit si dhe trajnimi i punonjesve ne ketij objekti duke krijuar situata te simuluar.

Detyrimet e punemarresit: Detyrimet kryesore jane:

1. Te njoh rregulloren e sigurimit dhe te mbrojtjes ne pune te leshuar nga Inspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punes dhe ti zbatoje ato ne pune.
2. Te dije mire shkaqet e mundshme te aksidenteve gjate aktivitetit, per cdo proces pune.
3. Te siguroje veten dhe punonjesit e tjere gjate procesit te punes ne zbatim.
4. Kur konstaton shenja te nje avarie te mundshme qe eshte burim aksidenti, ne radhe te pare te marre masa per eliminimin e saj, nderkohe lajmeron gjithte punonjesit per rrezikun dhe ve ne dijeni drejtuesin.
5. Te perdoren mjetet e mbrojtjes individuale ne pune si:
kapele, rrobat, doreza,
6. Te kete njohuri te mjaftueshme per ndihmen e shpejte.

PLANI I MONITORIMEVE MJEDISORE

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes, derdhjeve urbane etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore persa i perket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi eshte detyre e investitorit per pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 te ligjit "Per monitorimit e mjedisit ne Republiken e Shqiperise", kreu III, pika 10

Plani i monitorimit mjedisor eshte i inkorporuar ne projekt dhe perfshin inspektime dhe raportime rutine. Me poshte do te paraqesim disa monitorime qe do te realizohen per treguesit e trysnise ne mjedis qe jane detyre e investitorit ku ai do te bashkepuoje me instancat perkatese.

Monitorimi i cilesise se ajrit: Monitorimi para zhvillimit te aktivitetit per te vendosur kushtet fillestare, duhet bere ne zonat qe mendohet se mund te kete ndikim.

Monitorimi me aparate per ndotesit e ajrit, per avujt qe dalin nga tubi i aspirimit te ambientit te punes.

Monitorimi i zhurmave: Openimi i pajisjeve dhe i makinerive gjate gjithte procesit, kerkon te monitorohet niveli i zhurmave, i cili nuk duhet te kaloje nivelet e caktuara. Ndotja akustike ne mjediset e punes eshte paresore per vete investitorin, sepse sjell uljen e produktivitetit te punonjesve dhe rritje te stresit.

Investitori do te realizoje monitorim me aparatura, nje here perpara fillimit te punimeve, per te vendosur drejtimet kryesore te impakteve qe do te maten. Monitorimi fillestar i zhurmave do te kerkohet vetem aty ku kohezgjatja e potencialeve te ndikimeve dhe receptoreve e ndjeshem te justifikojte kete monitorim.



Monitorimi i mbetjeve te ngurta: Monitorimi gjate aktivitetit, lidhur me pastrimin dhe pergatitjen e ambientit, ka si synim qe te evitohen papastertite dhe te kete nje ndarje te mbeturinave sipas kategorise..

Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar qe te gjitha ndotjet e mundshme qe do t'i shkaktohen mjedisit nga puna ne kete ambient te jene brenda normave te lejuara. Investitori do te monitoroje vetem pikat per te cilat ai ndikon mbi to(pikat do te percaktohen nga organet kompetente), si dhe i dergojne keto te dhena ne Agjensine Rajonale te Mjedisit(ARM-ja e qarkut Tirane), te pakten dy here ne vit. Keto te dhena do te vihen ne dispozicion te inspektoreve te mjedisit gjate inspektimit te tyre.